

Eppc Kosovo kërkon një Teknik/e të Farmacisë në Istog për klientin e saj, i cili është një ndër kompanitë më të mëdha që operon në fushën e shitjeve të produkteve shëndetësore/farmaceutike.

#### Përgjegjësitë Kryesore:

- Shërben klientët duke verifikuar udhëzimet nga mjekët për sasi të duhura të ilaçeve për t'u dhënë pacientëve;
- Udhëzon pacientët se si dhe kur të marrin një ilaç të përshkruar nga mjeku dhe i informon për efektet anësore të mundshme që mund të përjetojnë nga marrja e ilaçit;
- Mban shënime dhe bën detyra të tjera administrative;
- Ndjek procesin e porosive, menaxhon nivelin e stokut dhe bën kontrollin e produkteve në mbarim të afatit;
- Mirëmban mjedis të sigurt dhe të pastër pune duke respektuar procedurat dhe rregullat e kompanisë.

#### Kërkesat për këtë pozicion janë:

- Shkolla e Mesme, preferohet drejtimi në Farmaci;
- Eksperiencë pune në fushën farmaceutike;
- Njohuri të avancuar të paketës Microsoft Office;
- Aftësi të shkëlqyera komunikimi, organizimi, dhe shitjeje;
- Të jetë person energjik, i motivuar, fleksibil dhe i/e aftë të punojë me saktësi nën presion;

#### Të dhënat:

<b>Pozicioni:</b>	Teknik/e të Farmacisë
<b>Vendndodhja:</b>	Istog;
<b>Pagesa:</b>	Në nivel shumë të mirë;
<b>Kontrata:</b>	Sipas Ligjit të Punës;
<b>Aplikimet mbyllen:</b>	31.10.2017.

#### Si të aplikoni:

Për të aplikuar për këtë mundësi punësimi, ju lutemi dërgoni CV-në tuaj dhe dokumentet e tjera shoqëruese duke **përmendur pozicionin për të cilin aplikoni** në adresën e e-mail<sup>it</sup>:

[kosovo@eppc.al](mailto:kosovo@eppc.al)

Ju do të kontaktoheni vetëm në qoftë se CV-ja juaj dhe dokumentet shoqëruese do të kualifikohen. Tek ne CV-ja juaj është e sigurt dhe trajtohet në konfidencialitet të plotë.